



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:262904  
Datë: 30.06.2020  
Numri i dokumentit: 00998147

**A.nr.1025/17**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit NTSH “M...” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e aktvendimit nr.06.2/237 i datës 04.05.2017, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit G.B. dhe përfaqësuesit të autorizuar të paditurës K.K., me datë 18.06.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit NTSH “M...” me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. **ANULOHET** aktvendimi me nr.06.2/237 i datës 04.05.2017, i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Me vendimin kontestues nr.06.2/237 i datës 04.05.2017, e paditura Dogana e Kosovës ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve me nr: R-6474/25.03.2017; R-6781/29.03.2017; R-7257/04.04.2017; R-7827/11.04.2017; R-7828/11.04.2017, të Zyrës së Brendshme Doganore “I...”.

Paditësi, përmes të autorizuarës, me padinë e paraqitur në gjykatë me datë 19.06.2017, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, si dhe për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës nr.06.2/237 të datës 04.05.2017.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë. Ka shtuar se e paditura në vendimin e kontestuar e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e DUD-ave kontestues, me arsyetimin se paditësi gjatë procedurës së zhdoganimit nuk ka paraqitur vlerë reale të mallit dhe si rrjedhojë e paditura e ka rritur bazën doganore të mallit, duke e obliguar paditësin të paguaj detyrime doganore më shumë se realisht do të duhej të kishte paguar në vlerën prej 17,694.39€. E paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 33 të KDAK-së, dhe

rivlerësimin e mallit e ka bazuar në nenin 35 të KDAK-së sipas të dhënave të disponueshme, duke mos i marr parasysh dokumentet përcjellëse të mallit. Padiësi për DUD-at kontestues i ka kryer pagesat bankare të cilat pagesa në cilësi të provës i'a dorëzoi edhe gjykatës, së bashku me sqarimet sa i përket mënyrës së pagesës, pasi që në këto pagesa përfshihen edhe disa DUD-a jo kontestues dhe faturat për këto DUD-a jo kontestues.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e padiësit kërkojë nga gjykata që të merr aktgjykim me të cilin e aprovon padinë dhe kërkesëpadinë e padiësit, e anulon aktvendimin kontestues si dhe ta obligojë të paditurën që padiësit t'ia kthejë vlerën e paguar të detyrimeve doganore në shumë e përmendur më lartë, respektivisht shumën 17,694.39€.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 04.12.2019 ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e padiësit si të pabazuar. Ka theksuar se vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit të fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala padiëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme.

Në seancën e shqyrtimit kryesor i autorizuari i të paditurës ka theksuar se edhe më tej e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e padiësit si të pabazuar. Ka shtuar se në fazën e ankimimit nga ana e Doganës janë administruar dokumentet e prezantuara nga ana e padiësit por i njëjti dokumentacion nga ana e Doganës është konsideruar i pa mjaftueshëm dhe jo i plotë për tu pranuar si vlerë reale për mallrat dhe deklaratat kontestuese. Sa i përket vlerës së kontestit të deklaruar në seancë nga pala padiëse nuk mund të deklarohet, për faktin se e njëjta as në padi nuk është paraqitur, me qëllim që edhe në përgjigje në padi të deklarohet në lidhje me të njëjtën. Sa i përket transfereve bankare të prezantuara në seancë dhe pas një shikimi të shpejt, lehtë mund të konstatohet se të njëjtat nuk është se janë të harmonizuara në tërësi dhe kjo mund të shihet fare qartë nga këto pagesa të cilat rezultojnë se disa prej tyre janë realizuar për eksportuesin nga Kina, por jo edhe për eksportuesin nga Bullgari, prej nga është importuar malli në Kosovë, e të cilat dokumente nuk janë administruar si prova as nga e paditura në procedurën administrative ankimore.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur në fjalën përfundimtare i propozoj gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin do të refuzonte si të pabazuar kërkesëpadinë padiësit dhe të lë në fuqi vendimin e Doganës si të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 18.06.2020, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimin me nr. 06.2/237 të datës 04.05.2017 të Doganës së Kosovës, Deklaratat Doganore Kontestuese, faturën e blerjes së mallit me nr.382 të datës 03.04.2017, Deklaratën Eksportuese të datës 03.04.2017, Deklarata Eksportuese të datës 10.04.2017, faturën e blerjes së mallit të datës 10.04.2017, faturën me nr.2017-03 të datës 07.03.2017, Kontratën e datës 14.07.2016, faturën me nr.2017-02 të datës 25.02.2017, Deklaratën Eksportuese të datës 03.04.2017, faturën me nr.382 të datës 03.04.2017, Kontrata Për Shitje Ndërkombëtare të datës 25.07.2013, Pagesat Bankare të datave 02.08.2017, 03.05.2017, 10.07.2017, DUD-at jo kontestues dhe faturat përcjellëse të këtyre DUD-ve, Proceset Mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenin 38 të LKA-së, në seancën e mbajtur me datë 18.06.2020, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë, dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e padiësit është e bazuar, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga DUD-at kontestues të Doganës së Kosovës, procesverbalet mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, shkresat e lëndës, si dhe aktvendimi

kontestues, ka nxjerr konstatimin se paditësi ka deklaruar mallin lëndor për zhdoganim në Zyrën Brendshme Doganore në "I...", me ç'rast pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-ve kontestues, Dogana e Kosovës me arsyetimin se vlera e mallit për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar me qëllim importi në Kosovë, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, ka rivlerësuar mallin lëndor në bazë të metodës së gjashtë (6) të vlerësimit, në mbështetje të nenin 35 të KDAK-së, duke u bazuar në të dhënat e disponueshme të Sektorit të Vlerës, të cilat janë marr nga zhdoganimet e mëhershme nëpër degë doganore. Nga kjo subjektit në procedurë këtu paditësit i është ngritur baza doganore dhe është detyruar që të paguaj taksa doganore më të larta se të deklaruar me faturat e mallit.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor, si dhe aktvendimi kontestues nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore.

Gjykata konstaton se e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues e ka vlerësuar dokumentacionin përcjellës të mallit të paraqitur nga paditësi si të pa mjaftueshëm, për arsye se dokumenti i bashkangjitur si kopje e deklarates eksportuese nuk përputhet në kuptim të peshave të mallit, vlerës së saj dhe përshkrimit të mallit, mirëpo një arsyetim i këtillë për gjykatën nuk është i bazuar në dispozita ligjore, sepse askund nuk parashihet me ligj obligimi që deklarates doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit duhet ti bashkëngjitet edhe deklarata eksportuese. Përkundrazi sipas nenit 123 të UA nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave shprehimisht thuhet që "*Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklarates doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti*". Në kontekst të këtij argumenti për gjykatën është e pa pranueshme se si e paditura nuk e ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga paditësi, në procedurë të zhdoganimit të mallit në raport me kërkesat ligjore, siç nuk ka kërkuar as dokumente tjera shtesë për të vërtetuar saktësinë e të dhënave nga deklaratat doganore dhe nuk e ka njoftuar paditësin në formë të shkruar për dyshimin se vlera e deklaruar e mallit nuk është vlera reale e paguar, siç përcaktohet me dispozita të nenit 72 të KDA-së dhe nenit 92 të UA nr.11/2009.

Po ashtu, gjykata konstaton se proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave të cilat i ka paraqitur e paditura si prova në këtë konflikt administrativ dhe në cilat e paditura e ka bazuar rivlerësimin e mallit për paditësit janë të mangëta dhe jo të plota, sepse në to nuk ka përshkrim të mallit, nuk dihet origjina e mallit, nuk dihet kualiteti i mallit dhe të dhënat tjera të kërkuara për mallrat e ngjashëm siç përcaktohet me nenin 61 pika d) të UA.nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109.

Gjykata në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, ka pranuar si provë të re të dorëzuar nga paditësi dokumentet mbi pagesat bankare të datave 03.05.2017, 10.07.2017 dhe 02.08.2017, në bazë të nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 e cila dispozite parasheh se "*Gjykata mund të lejoj prova të reja kur :4.1. provat nuk kanë qenë në dispozicion gjatë kohës së kundërshtimit të vendimit; 4.2. provat janë të nevojshme për të evituar shfaqjen e padrejtësive për palën e cila e kërkon shqyrtimin e tyre*". Këto prova janë pranuar nga gjykata, së bashku me DUD-at jo kontestues me nr: R-4872/08.03.2017, R-5520/19.03.2017, R-4960/09.03.2017, R-6168/22.03.2017, R-8515/19.04.2017, R-9174/26.04.2017, dhe R-6474/25.03.2017, me faturat e blerjes së mallit për këta DUD-a, për arsye se në radhë të parë pagesat bankare nuk kanë ekzistuar më herët, pasi që janë realizuar më vonë, sipas marrëveshjes në mes të paditësit dhe eksportuesit, respektivisht kontratës për shitje ndërkombëtare të datës 25.07.2013, ku në nenin tre të saj, është paraparë se "*palët në kontratë bien dakord shprehimisht në tetë (8) muaj periudhë grejs për të filluar pagesën e mallrave të furnizuara*", dhe në radhë të dytë për të evituar shfaqjen e padrejtësive për palën paditëse. Siç

shihet nga kjo kontratë palët kontraktuese janë marr vesh që pagesa e mallrave të furnizuara nga paditësi të bëhet më vonë, pra pas arritjes së mallit në Kosovës dhe kjo edhe ka ndodhur në rastin konkret.

Gjykata konstaton se paditësi në këtë procedurë të konfliktit administrativ për DUD-at nr.R-6474/25.03.2017; R-6781/29.03.2017; R-7257/04.04.2017; R-7827/11.04.2017; R-7828/11.04.2017, i ka paraqitur gjykatës faturën e mallit lëndor me nr:0384 të datës 10.04.2017, faturën me nr.2017-03 të datës 07.03.2017, faturën me nr.2017-02 të datës 25.02.2017, faturën me nr.0382 të datës 03.04.2017, deklaratat eksportuese, urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të mallit të datës 03.05.2017, 02.08.2017, 10.07.2017, pagesa këto të cilat janë realizuar në bazë të nenit 3 të kontratës së shitblerjes dhe të cilat përmbajnë numrat e faturave përcjellëse të mallit por edhe të faturave të tjera, të cilat nuk janë kontestuese dhe në këtë aspekt këto dokumente janë të harmonizuara, sa i përket vlerës së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të KDA-së.

Gjykata konsideron se aplikimi i metodës së gjashtë të vlerësimit (MV6), në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e radhës e vlerësimit gjegjësisht metoda e 6 e vlerësimit, duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor dhe dokumentacionin e dorëzuar me kërkesë nga paditësi si faturat e mallit, dhe dokumentacioni tjetër përcjellës i mallit.

Sipas nenit 123 të UA nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave shprehimisht thuhet që *“Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*. Rrjedhimisht për gjykatën është e pa pranueshme se si e paditura nuk e ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga paditësi, në procedurë të zhdoganimit të mallit në raport me kërkesat ligjore, siç nuk ka kërkuar as dokumente tjera shtesë për të vërtetuar saktësinë e të dhënave nga deklarata doganore dhe nuk e ka njoftuar paditësin në formë të shkruar për dyshimin se vlera e deklaruar e mallit nuk është vlera reale e paguar, siç përcaktohet me dispozita të nenit 72 të KDA-së dhe nenit 92 të UA nr.11/2009.

Në rrethanat e rastit konkret, gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ, për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, për faktin se vetëm konstatimi i të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit është vlerësuar si provë e pamjaftueshme që vlera e deklaruar nga subjekti në procedurë të pranohet si vlerë e pranueshme për qëllime të doganore, pa dhënë një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore dhe arsyen për ngritjen e bazës doganore, nuk mund të cilësohet vendimi i drejtë dhe i ligjshëm dhe i cili është marr në respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-028, si ligj i aplikueshëm në kohën kur është nxjerr vendimi kontestues.

Prandaj gjykata e obligon të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje, të deklarohet lidhur provat e paraqitura nga paditësi dhe të administruara nga gjykata, përkatësisht faturat e mallit lëndor me nr.382 të datës 03.04.2017, nr.2017-02 të datës 25.02.2017, nr.2017-03 të datës 07.03.2017, nr.2017-01 e datës 02.02.2017, nr.0372 të datës 14.03.2017, nr.0371 të datës 08.03.2017, nr.0374 të datës 21.03.2017, nr.0385 të datës 18.04.2017, nr.0387 të datës 24.04.2017, urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të mallit të datës 03.05.2017; 02.08.2017; 10.07.2017, cilat përmbajnë edhe numrat e faturave përcjellëse të mallit si dhe faturave të tjera, të cilat nuk janë kontestuese, deklaratat eksportuese. Gjykata po ashtu kërkon nga e paditura që në ri procedurë para se të aplikoj të dhënat e disponueshme që disponon për mallin lëndor, të vlerësoj metodat paraprake të vlerësimit gjegjësisht metodën e parë, të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit përcjellës të mallit në aspektin e harmonizimit të vlerës së mallit të deklaruar, ashtu që të shqyrtoj pretendimet e paditësit se a ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave

të Kosovës nr.03/L-109, pastaj të verifikohet vlera e paguar e faturave për mallrat e importuara sipas transaksioneve bankare dhe nëse ajo harmonizohet me vlerën e deklaruar, sipas dokumentacionit përcjellëse të mallit lëndor. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave, duke pasur parasysh edhe praktiken doganore në rastet e ngjashme.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal**  
**A.nr.1025/17, datë 18.06.2020**

**G j y q t a r i**  
Rexhep Gashi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.